



QATEK



Co-funded by the
Erasmus+ Programme
of the European Union



POLITIKA PËR PËRMIRËSIMIN DHE SIGURIMIN E CILËSISË NË PËRGATITJEN E MËSIMDHËNËSVE NË KOSOVË

Fakulteti i Edukimit, UP

Kjo politikë u përgatit me mbështetjen e Projektit QATEK (Drejt Përgatitjes së Mësimdhënësve me Orientim drejt Cilësisë në Kosovë) të financuar nga Programi Erasmus Plus. Qëllimi i përgjithshëm i projektit është të zhvillohet një kulturë e cilësisë në institucionet e përgatitjes së mësimdhënësve për të rritur profesionalizmin e tyre në sistemin shkollor në Kosovë. Projekti financohet nga Programi ERASMUS+ dhe zbatohet nga Fakulteti i Edukimit i UP-së, në bashkëpunim me Universitetin e Lubjanës (Slloveni), Universitetin e Tallinit (Estoni), Universitetin LUMSA në Romë (Itali), Universitetin e Gjilanit “Kadri Zeka”, Universitetin e Gjakovës “Fehmi Agani”, dhe Universitetin e Mitrovicës “Isa Boletini”.

Prishtinë, janar 2021

Tabela e përmbajtjes

Parathënie	4
1. Hyrje	5
Qëllimi i politikës	8
2. Korniza referencë për politikën për sigurim të cilësisë në përgatitjen e mësimit të mesëm	9
2.1 Korniza vendore për profesionin e mësimit të mesëm	9
2.1.1 Standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë	10
2.1.2 Korniza strategjike për zhvillim të mësimit të mesëm	10
2.2 Korniza evropiane referencë për profesionin e mësimit të mesëm	12
2.2.1 Të kuptuarit e realitetit të ndërlikuar të punës së mësimit të mesëm	12
2.2.2 Korniza e kompetencave të përgatitjes së mësimit të mesëm	14
3 Politika për sigurim të cilësisë për përgatitjen e mësimit të mesëm në Kosovë	16
3.1 Niveli institucional	16
3.2 Niveli i Programit	18
3.3 Niveli i klasës	20
4. Strategjia e zbatimit	20
5. Referencat	1

Parathënie

Përgatitja e mësimit në Kosovë ka qenë e përfshirë në reformë të vazhdueshme e cila ka qenë e përqëndruar në dimenzionin e reformës strukturore dhe reformës së implementimit të programeve. Në nivel të reformës strukturore, programet për përgatitjen e mësimit janë avancuar nga kualifikimi dy vjeçar (të ofruara në ish Shkollat e Larta Pedagogjike) në kualifikim katër vjeçar që filluan të ofrohen me themelimin e Fakultetit të Edukimit në vitin 2002. Në vitin 2011, në kuadër të tendencës së rritjes së standardit të kualifikimit të mësimit, legjislacioni e bëri të obligueshme që mësimit të lëndor të kenë kualifikimin master që reflektojnë një përmbajtje të balancuar midis aspektit akademik, didaktik dhe përvojës praktike në shkollë. Paralelisht me këtë, përgatitja e mësimit është udhëhequr edhe nga zhvillimet e ndryshme në profesionin e mësuesisë (si për shembull Korniza Strategjike e Zhvillimit të Mësimit në vitin 2017) dhe reforma kurrikulare në sistemin e arsimit parauniversitar. Kjo është e lidhur ngushtë me implementimin e programeve të Fakultetit të Edukimit që në ditët e sotme kanë për detyrë të përgatisin mësimit që mund të përballen me sfidat e të qenit mësues në shkollë dhe kompleksitetin në të cilin është vendosur profesioni i mësuesisë. Nga mësimit të rinj pritet që të kryejnë një detyrë që është shumë ndryshe nga çfarë ka qenë 20 vite më parë përderisa njohuritë shkencore rreth cilësisë së mësimit dhe mësimit janë avancuar poashtu. Shoqëritë në vitin 2021 janë shumë më komplekse dhe përballen me sfidat e ndryshme përderisa poashtu ka ndryshuar edhe rëndësia që ka njohuria dhe informata krahas trendeve të zhvillimeve teknologjike dhe globalizimit. Prandaj, ky kontekst që është duke ndryshuar në vazhdimësi paraqet një lidhje dhe presion të drejtëpërdrejtë për institucionet që përgatisin mësimit dhe mënyrën si implementojnë ato programet e tyre.

Fakulteti i Edukimit ka bërë një rrugëtim në drejtim të përshtatjes ndaj kontekstit aktual duke u përfshirë në shumë projekte zhvillimore për të avancuar cilësinë e implementimit të programeve studimore. Megjithatë, perceptimi i tanishëm tek komuniteti arsimor dhe shoqëria, poashtu bazuar edhe në dëshmitë për cilësinë e mësimit në shkollë, është që cilësia e përgatitjes së mësimit duhet të zhvillohet tutje. Ky dokument paraqet një hap më shumë drejt përshtatjes ndaj këtij konteksti duke zhvilluar një politikë dhe mekanizëm për të kuptuar proceset dhe praktikën e implementimit të programeve studimore në Fakultet të Edukimit dhe për të identifikuar veprimet që do të ndryshojnë realitetin ekzistues në kontekst afatmesëm dhe afatgjatë. Për më shumë, kjo politikë (ky dokument) do të shpie në ndryshimin e qasjes tradicionale ad-hok të reformës drejtë intervenimeve më gjithëpërfshirëse të bazuar në dëshmi duke përfshirë të gjitha palët ndërsa duke adresuar në të njëjtën kohë përmbajtjen programore, praktikën e personelit akademik si dhe praktikën administrative dhe menaxheriale. Ky është një model i ri i reformës në përgatitjen e mësimit në Kosovë që do të shpie drejtë ndryshimit afatgjatë dhe të qëndrueshëm në cilësinë e përgatitjes së mësimit që është esenciale për të arritur synimin e ndryshimit të paradigmes tradicionale të reformës së përgatitjes së mësimit dhe cilësisë së mësimit në shkollë. Ky zhvillim do të shënojë fundin e fazës ‘të bëjmë më shumë nga ajo që kemi bërë’ dhe fillimin e fazës ‘të përgatisim mësimit më ndryshe dhe për një qëllim tjetër’ në sistemin e përgatitjes së mësimit në Kosovë.

Prof.Ass.Dr. Blerim Saqipi

Dekan

1. Hyrje

Përgatitja e mësimdhënësve u referohet politikave dhe procedurave të dizajnuara për pajisjen e mësimdhënësve të ardhshëm me njohuri, qëndrime, sjellje dhe shkathtësi, të cilat iu duhen që ta kryejnë në mënyrë efektive detyrën e tyre në klasë, shkollë dhe komunitetin e gjerë. Edhe pse, në mënyrë ideale, përgatitja e mësimdhënësve do të duhej të konceptohej dhe të organizohej si një vazhdimësi e rrjedhshme, ajo shpesh ndahet në këto faza: Trajnimi/përgatitja e mësimdhënësve para-shërbimit (një program para futjes në shërbim dhe para hyrjes në klasë si mësimdhënës plotësisht i përgjegjshëm); Pjesa hyrëse (procesi i ofrimit të trajnimit dhe mbështetjes gjatë viteve të para ose vitit të parë të mësimdhënies në një shkollë të caktuar); dhe zhvillimi gjatë shërbimit ose zhvillimi i vazhdueshëm profesional (ZHVP). Sipas Kornizës së BE-së për mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve për rezultate më të mira të të nxënësve (2013), mësimnxënia profesionale është një vazhdimësi që fillon nga përgatitja e mësimdhënësve para-shërbimit, dhe shtrihet gjatë fazës hyrëse, dhe vazhdon gjatë gjithë karrierës.

Korniza e re e Kurrikulës së Kosovës (e lansuar në vitin 2011 dhe e zbatuar në faza pas pilotimit) fokusohet në mësimdhënien dhe mësimnxënien e bazuar në kompetenca, duke e zhvendosur fokusin nga përvetësimi i njohurive në ndërtimin e kompetencave, dhe nxit tranzicionin nga mësimdhënia dhe mësimnxënia e bazuar në objektiva dhe përmbajtje të mësimdhënies drejt metodologjive më bashkëkohore të mësimdhënies dhe mësimnxënies së bazuar në rezultate dhe zhvillim të kompetencave tek fëmijët. Prandaj, tashmë roli i mësimdhënësit konsiderohet se shkon përtej ofrimit të informacionit drejt nxitjes së një mjedisi të përshtatshëm për përfshirjen dhe zhvillimin e kompetencave kyçe. Zbatimi i kësaj kornize kurrikulare kërkon që programet e përgatitjes së mësimdhënësve të përgatisin profesionistë që mund të mbështesin zhvillimin e mësimdhënësve të ardhshëm që i përgjigjen kësaj reforme dhe reformave të ngjashme të kurrikulës.

Sipas Kornizës Strategjike për Zhvillim të Mësimdhënësve në Kosovë (aprovuar nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës në vitin 2017), profili i kompetencave të mësimdhënësve konsiston në shtatë standarde që përcaktojnë se çka duhet të dinë mësimdhënësit, çka duhet të jenë në gjendje të bëjnë, dhe si të sillen në këtë profesion. Këto standarde janë grupuar në katër fusha të mësimdhënies: Vlerat profesionale (qëndrimet dhe sjelljet); njohuritë dhe të kuptuarit profesional; praktika profesionale; dhe mësimdhënia dhe angazhimi profesional. Këto fusha janë të ndërlidhura dhe plotësojnë njëra-tjetrën.

Në Kosovë, përgatitja e mësimdhënësve është e organizuar në pesë institucione publike të arsimit të lartë përmes Fakulteteve të Edukimit. Ligji për arsimin parauniversitar në Kosovë (2011) dhe Ligji për arsimin e lartë në Kosovë (2012) përcaktojnë institucionet përgjegjëse për përgatitjen e mësimdhënësve në arsimin parauniversitar. Sipas Ligjit për Arsimin e Lartë, institucionet publike të arsimit të lartë janë përgjegjëse për ofrimin e programeve të përgatitjes së mësimdhënësve para-shërbimit për në Kosovë. Këto programe ofrohen në Fakultetet e Edukimit në Universitetin e Prishtinës, Universitetin e Gjilanit, Universitetin e

Gjakovës, Universitetin e Mitrovicës dhe Universitetin e Prizrenit. Të gjitha këto programe kërkojnë akreditim nga Agjencia për Akreditim e Kosovës.

Programet e përgatitjes së mësimdhënësve për nivelet parashkollor dhe fillor ofrohen në të pesë universitetet publike, dhe kohëzgjatja e kërkuar e studimeve për të përgatitur mësimdhënësit e edukimit parashkollor dhe fillor është të paktën katër vjet (240 ECTS). Përgatitja e mësimdhënësve lëndorë ofrohet vetëm në Universitetin e Prishtinës. Kohëzgjatja e studimeve për të përgatitur mësimdhënësit lëndorë është të paktën 300 ECTS, nga të cilat të paktën 180 ECTS kërkojnë për komponentën akademike (niveli BA) dhe 120 ECTS (niveli MA) për komponentën pedagogjike dhe praktike. Edhe përgatitja e mësimdhënësve për Arsim Profesional ofrohet vetëm në Universitetin e Prishtinës, dhe bartë të paktën 300 ECTS, nga të cilat 180 ECTS për komponentën profesionale dhe 120 ECTS (MA) komponentën pedagogjike. Programeve për përgatitje të mësimdhënësve u kërkohet të jenë në pajtueshmëri me standardet profesionale të përcaktuara nga Korniza Strategjike për zhvillim të mësimdhënësve dhe Korniza e Kurrikulës/Kurrikula Bërthamë për nivelin përkatës (KEEN, 2019).

Faza hyrëse në mësimdhënie përfshin procesin e ofrimit të trajnimit dhe mbështetjes gjatë viteve të para të mësimdhënies, dhe parashikon një program të veçantë mentorimi. Megjithatë në Kosovë kjo ende nuk është adresuar siç duhet. Është fazë e përshtatjes me kulturën e punës në shkollë, fazë e zhvillimit të mëtejshëm të kompetencave për mësimdhënie të mirë dhe kujdes për zhvillimin personal (KEEN, 2019). Megjithëse kjo është paraparë me sistemin e licencimit të mësimdhënësve të rinj, Kosova nuk ka një sistem plotësisht të zhvilluar dhe funksional për fazën hyrëse të mësimdhënësve të rinj, që në një farë mënyre është një sfidë në politikën e përgjithshme dhe praktikën e zhvillimit të mësimdhënësve në kontekstin e Kosovës.

Nga ana tjetër, zhvillimi profesional i mësimdhënësve (në shërbim) është nën përgjegjësinë e disa institucioneve që kanë një rol në zhvillimin profesional të mësimdhënësve, duke përfshirë këtu Drejtoritë Komunale të Arsimit, shkollat dhe institucionet e tjera arsimore, Inspektoratin e Arsimit, institucionet/organizatat, agjencitë dhe OJQ-të, dhe projektet ndërkombëtare të financuara nga donatorët, të cilët ofrojnë kurse të zhvillimit profesional dhe punojnë drejt zhvillimit profesional të mësimdhënësve. Secili prej tyre ka përkufizimin e vet për cilësinë dhe mënyrën e funksionimit. Ata kanë edhe larmi të konsiderueshme në përmbajtje, kohëzgjatje dhe kritere të vlerësimit, dhe ofrohen në nivele të ndryshme akademike. Përkundër iniciativave për t'i përcaktuar institucionet publike që do të kishin rolin udhëheqës për programe të caktuara të ZHPM-së, MASH nuk ishte i suksesshëm në këtë dhe si rezultat ZHPM sot kryesisht varet nga projektet ndërkombëtare të financuara nga donatorët (KEEN, 2019). Të gjitha programet e ZHPM-së kërkojnë akreditim nga MASH-i.

Në kuadër të fushëveprimit të projektit QATEK, u kryen dy analiza të gjendjes në vitin 2020, duke përfshirë: (i) *Analizën e gjendjes për praktikën e sigurimit të cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit* dhe (ii) *Analizën e gjendjes për programet për përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit për ciklin fillor*.

Analiza e gjendjes për praktikat e sigurimit të cilësisë tregoi se *procesi i akreditimit* konsiderohet si kornizë udhëzuese për sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe përgatitjen e mësimdhënësve (QATEK, 2020). Edhe pse procesi i akreditimit ka ndikuar në zhvillimin e mekanizmave të brendshëm (institucionalë) për sigurim të cilësisë nëpër institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit, akreditimi është i orientuar nga jashtë dhe drejtohet nga tregues sasiore. Për pasojë, standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë nuk mund të përgjithësohen si përmirësim i cilësisë në tërë procesin e përgatitjes së mësimdhënësve. Standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë në arsimin e lartë nuk duhet të imponohen si model i përgjithshëm për përmirësimin e cilësisë në arsimin e lartë dhe përgatitjen e mësimdhënësve. Standardet janë udhëzime që u ndihmojnë institucioneve individuale t'i kuptojnë nevojat e tyre specifike dhe t'i rregullojnë mënyrat e punës për të përmirësuar cilësinë institucionale. Prandaj, institucionet për përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit kanë nevojë për tregues/standarde të përshtatshme (si cilësore ashtu edhe sasiore) kur synojnë të zhvillojnë përgatitje të mësimdhënësve të orientuar drejt cilësisë, dhe të sigurojnë profesionalizmin e mësimdhënësve të ardhshëm. Në këtë mënyrë, palët e brendshme të interesit mund të komunikojnë më mirë me standardet dhe udhëzimet e brendshme për përmirësimin e cilësisë dhe të ofrojnë angazhim përmbytësor drejt zhvillimit të një kulture të cilësisë në kuadër të institucioneve.

Analiza e gjendjes për programet për përgatitje të mësimdhënësve para-shërbimit (2020) konfirmon se njohuritë dhe shkathtësitë e lidhura me mësimnxënien dhe mësimdhënien janë më pak të zhvilluara, dhe roli i përgatitjes së mësimdhënësve është i konceptuar më pak i ngushtë se që realisht duhet të jetë. Gjetjet nga analiza e gjendjes për implementim të programeve tregojnë se zhvillimi i njohurive është prioritet në programet siç theksohet nga profesorët e programit dhe anaiza e dokumenteve programore. Sidoqoftë, shkathtësitë zhvillohen kryesisht gjatë periudhës së praktikës dhe zhvillimi i shkathtësive nuk është prioritet në programe. Në anën tjetër, zhvillimi i qëndrimeve, besimeve dhe vlerave për profesionin e mësimdhënësit, është komponenti më së paku i adresuar i programeve. Disa institucione për përgatitje të mësimdhënësve e kanë injoruar plotësisht komponentin e qëndrimeve, besimeve dhe vlerave, çka pasqyrohet edhe në nivelin e shkollimit parauniversitar.

Për ta përmbledhur, edhe pse politikat dhe mekanizmat ekzistues për sigurimin e cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve para-shërbimit shërbejnë si një bazë për të kuptuar mënyrat e ofrimit të përgatitjes së mësimdhënësve të orientuar drejt cilësisë, vet përgatitja e mësimdhënësve imponon nevoja specifike që kërkojnë zhvillimin e një kornize të përshtatur të politikave.

Qëllimi i kësaj politike është të adresojë avancimin e politikave dhe praktikave për përmirësim dhe sigurim të cilësisë në përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit si element vendimtar në vazhdimësinë e zhvillimit të mësimdhënësve.

Qëllimi i politikës

Qëllimi i përgjithshëm i këtij dokumenti të politikës është të sigurojë një kornizë dhe udhëzime zbatimi për institucionet për përgatitjen e mësimit në Kosovë, duke prezantuar një sistem të brendshëm për sigurim të cilësisë për përgatitjen e mësimit para-shërbimit. Ky dokument synon të sigurojë një kornizë të referencës për institucionet për përgatitjen e mësimit para-shërbimit në përafrimin e programeve dhe praktikave institucionale në mënyrë që të sigurohet se praktikat për përgatitjen e mësimit para-shërbimit çojnë në zhvillimin e profesionalizmit të kërkuar të mësimit në kontekstin shkollor vendor dhe ndërkombëtar. Politika siguron një kornizë që përcakton pikat referuese për standardet e programeve për përgatitjen e mësimit para-shërbimit, si dhe përshkruan proceset dhe instrumentet që çojnë në identifikimin e fushave për përmirësim, duke mundësuar kështu veprime institucionale për t'i përmirësuar praktikat ekzistuese.

2. Korniza referencë për politikën për sigurim të cilësisë në përgatitjen e mësimit në Kosovë

Qëllimi i kësaj pjese është të përcaktojë kornizat ekzistuese referencë për politikën për sigurim të cilësisë së përgatitjes së mësimit në Kosovë para-shërbimit në nivelin kombëtar (*shih pjesën 2.1*) dhe nivelin evropian (*shih pjesën 2.2*).

2.1 Korniza vendore për profesionin e mësimit në Kosovë

Është e rëndësishme të theksohet se përgatitja e mësimit në Kosovë funksionin brenda kontekstit vendor në të cilin janë përfshirë profesioni i mësimit dhe funksionimi i institucioneve të arsimit të lartë. Duke marrë këtë parasysh, ekzistojnë tri referenca të rëndësishme të politikave lokale që formësojnë zhvillimin e profesionit të mësimit dhe përgatitjen e mësimit në Kosovë. Këto janë: sistemi i akreditimit të jashtëm për arsimin e lartë, Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimit dhe Politika për Kurrikulën Kombëtare.

- **Standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë.** Standardet e Kosovës për sigurimin e jashtëm të cilësisë (akreditimi institucional dhe i programeve) bazohen në Standardet dhe Udhëzimet Evropiane për Sigurimin e Cilësisë. Ato zbatohen rregullisht dhe institucionet e arsimit të lartë planifikojnë zhvillimet bazuar në këto standarde. Ato janë të përgjithshme dhe nuk trajtojnë tema specifike. Institucionet e Arsimit të Lartë pritet të zhvillojnë mekanizmat e tyre të brendshëm për t'iu përgjigjur këtyre standardeve të jashtme.
- **Korniza Strategjike për zhvillim të mësimit.** Është një politikë kombëtare që ka paraparë politika dhe praktika që përdoren si pika të referencës për zhvillimin e mësimit përgjatë vazhdimësisë së fazës fillestare (para shërbimit), fazës hyrëse dhe zhvillimit profesional gjatë shërbimit. Dokumenti ofron një gamë të gjerë të kompetencave për mësimit dhe që duhet të adresohen në faza të ndryshme të karrierës, si dhe ofron një pikë të mirë të referencës për profesionalizmin e kërkuar të mësimit në kontekstin e Kosovës. Për fazën e përgatitjes së mësimit para-shërbimit, dokumenti specifikon grupin e kompetencave që duhet të aspirojë të zhvillojë kjo përgatitje.
- **Politika e Kurrikulës së Kosovës.** Politika e kurrikulës (Korniza Kurrikulare e lansuar në vitin 2011), në bazë të qasjes së bazuar në kompetenca, ka paraparë një tranzicion në mënyrën se si mësimit i planifikojnë dhe japin mësim, me synimin për t'i shtyrë mësimit drejt një qasjeje me nxënësin në qendër dhe arsimimin e bazuar në rezultate. Tranzicioni përmes së cilit pritet të kalojnë mësimit kosovarë, përqendrohet në braktisjen e qasjeve të mësimit të fokusuar në mësimit drejt qasjes së krijimit të mësimit që krijojnë kurrikulat dhe i udhëheqin ndryshimet në mësimit dhe mësimit në shkollë.

Dy referencat e para të politikës shpjegohen në mënyrë më të detajuar në pjesën vijuese, për shkak të rëndësisë së tyre për qëllimet e këtij dokumenti.

2.1.1 Standardet dhe treguesit e performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë

Agjencia e Kosovës për Akreditim (tani e tutje AKA) mbështet zbatimin e sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë dhe përgatitjen e mësimdhënësve përmes proceseve të akreditimit institucional dhe të programeve. Për t'i kuptuar më mirë kërkesat për akreditim të institucioneve dhe programeve të arsimit të lartë, AKA-ja ka zhvilluar një manual me standarde dhe tregues të performancës për sigurimin e jashtëm të cilësisë, i cili bazohet në *Standardet dhe Udhëzimet për Sigurimin e Cilësisë në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë (ESG)* (Kaçaniku, 2018).

Akreditimi/riakreditimi i institucioneve të arsimit të lartë fokusohet në fushat tematike vijuese:

- misioni publik dhe objektivat institucionale,
- planifikimi strategjik, qeverisja dhe administrimi,
- planifikimi dhe menaxhimi financiar,
- integriteti akademik, përgjegjësia dhe llogaridhënia publike,
- menaxhimi i cilësisë,
- mësimnxënia dhe mësimdhënia,
- hulumtimi,
- stafi, proceset e punësimit dhe zhvillimi profesional,
- administrimi i studentëve dhe shërbimet mbështetëse,
- burimet dhe objektet e mësimin, dhe
- bashkëpunimi institucional

Përderisa për *akreditimin/riakreditimin e programeve të studimit* vlerësohen:

- misioni, objektivat dhe administrimi;
- menaxhimi i cilësisë;
- stafi akademik;
- përmbajtja e procesit arsimor;
- studentët;
- hulumtimi, dhe;
- infrastruktura dhe burimet.

2.1.2 Korniza strategjike për zhvillim të mësimdhënësve

Dokumenti kryesor i politikave për zhvillimin e mësimdhënësve është *korniza strategjike për zhvillim të mësimdhënësve në Kosovë* (MASH, 2017). Korniza strategjike për zhvillim të mësimdhënësve - përcakton standardet e profesionit të mësimdhënësit gjatë gjithë karrierës (para shërbimit, faza e hyrjes në profesion, dhe zhvillimi profesional) dhe zbërthen kompetencat e mësimdhënësve në faza të ndryshme të zhvillimit.

Ky dokument është zhvilluar si përpjekje për të përmirësuar organizimin e sistemit të zhvillimit të mësimdhënësve dhe synon:

- Ofrimin e një plani koherent të karrierës për zhvillimin e mësimdhënësve në Kosovë, duke përfshirë një sërë standardesh të unifikuara të performancës/kompetencave në pesë nivele të karrierës/licencimit të mësimdhënësve, dhe caktimin e prioriteteve për veprimet që do të ndërmerren për periudhën 2017-2021
- Energjizimin e diskutimit dhe veprimit në nivele të ndryshme të sistemit arsimor (niveli qendror, komunal dhe shkollor) për të siguruar që të gjithë nxënësit në Kosovë, në çdo klasë, të jenë të frymëzuar për mësimnxënie nga mësimdhënës të devotshëm, të cilët janë efikasë dhe të kujdesshëm ndaj nxënësve të tyre (MASHT, 2017, f. 10).

Korniza strategjike për zhvillim të mësimdhënësve përcakton standardet e profesionit, të cilat shërbejnë si referencë për përgatitjen e mësimdhënësve, mbështetjen dhe zhvillimin profesional, vlerësimin e performancës dhe ngritjen në detyrë të mësimdhënësve. Standardet profesionale të mësimdhënësve janë të organizuara në katër fusha të mësimdhënies dhe korrespondojnë me standardet për mësimdhënësit (shih *Tabelën 1* për informacion të detajuar).

Tabela 1: Korniza e përgjithshme e standardeve të profesionit të mësimdhënësit/kompetencat e përgjithshme (MASH, 2017, f. 14)

Fushat e mësimdhënies	Standardet për mësimdhënësit
<i>Vlerat, qëndrimet dhe sjellja profesionale</i>	Njih dhe mbështet vlerat dhe kriteret kyçe të përcaktuara nga MASH/Përgjegjësi ndaj detyrave dhe detyrimeve të punës
<i>Njohuritë dhe të kuptuarit profesional</i>	Demonstron qëndrime dhe sjellje pozitive dhe objektive për mirëqenien e nxënësve dhe mësimdhënien Demonstron njohuri për kurrikulën/përmbajtjen e lëndës dhe metodologjinë didaktike profesionale për lëndën
<i>Shkathtësitë dhe praktika profesionale</i>	Planifikon zbatim efektiv të mësimdhënies dhe mësimnxënies Planifikon vlerësimin e vazhdueshëm (vlerësim për mësimnxënien), ofron reagime dhe raporton për mësimnxënien e nxënësve
<i>Mësimnxënia profesionale dhe angazhimi</i>	Angazhohet në zhvillim të vazhdueshëm profesional Angazhohet profesionalisht me kolegë, prindër dhe komunitetin

2.2 Korniza evropiane referencë për profesionin e mësimdhënësit

Kjo pjesë synon të ofrojë këndvështrime të ndryshme rreth zhvillimit të një kornize për përgatitjen e mësimdhënësve në shërbim. *Së pari*, diskutohen kërkesat dhe ndërlikimet e profesionit të mësimdhënësve duke treguar aspektet kryesore që duhet të merren parasysh nga institucionet gjatë përgatitjes së mësimdhënësve të ardhshëm. *Së dyti*, konceptualizohen gjerësisht kompetencat e mësimdhënësve dhe lidhemi me praktikën e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve brenda kontekstit të përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë. *Së treti*, kjo pjesë ofron kornizën për zhvillimin e kompetencave të mësimdhënësve (marrë nga korniza e BE-së). *Së fundmi*, ofrohen konsiderata praktike për institucionet e përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë se si të sigurohet zbatim i harmonizuar i kornizës së përgatitjes së mësimdhënësve, të orientuar drejt cilësisë..

2.2.1 Të kuptuarit e realitetit të ndërlikuar të punës së mësimdhënësve

Rolet dhe realiteti i punës së mësimdhënësve po ndryshon, dhe po kështu edhe pritjet për to: mësimdhënësve u kërkohet të japin mësim në klasa gjithnjë e më të ndryshme, të integrojnë nxënës me nevoja të veçanta, të përdorin TIK në mësimdhënie në mënyrë efektive, të përfshihen në proceset e vlerësimit dhe llogaridhënies, dhe t'i përfshijnë prindërit në shkolla (Fullan, 2007; Day & Gu 2010; Day, 2017). Hargreaves (2003, fq. 24) argumenton se mësimdhënësit duhet të zhvillojnë një profesionalizëm të ri, me të cilin:

- Promovojnë mësimnxënie të thellë kognitive
- Mësojnë të japin mësim në mënyra që nuk ua kanë mësuar
- Përkushtohen ndaj mësimnxënies së vazhdueshme profesionale
- Punojnë dhe mësojnë në ekipe kolegjale
- I trajtojnë prindërit si partnerë në mësimnxënie

- Zhvillojnë dhe shfrytëzojnë inteligjencën kolektive
- Ndërtojnë kapacitet për ndryshim dhe rreziqe
- Nxisin besimin në proces

Për më tej, Hattie (2009, fq. 238-239) ofron gjashtë indikacione që tregojnë kompleksitetin e roleve të reja të mësimit:

1. Mësuesit janë ndër ndikuesit më të fuqishëm në mësuesinë;
2. Mësuesit duhet të jenë drejtues, ndikues, të kujdesshëm dhe të angazhuar në mënyrë aktive në pasionin e mësimit dhe të nxënësve;
3. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për atë që mendon dhe di secili nxënës, të ndërtojnë kuptime dhe përvoja kuptimplota me këto njohuri, të kenë njohuri dhe ta kuptojnë përmbajtjen e lëndëve të tyre, në mënyrë që të sigurojnë përgjigje kuptimplota dhe të përshtatshme ashtu që secili student të lëvizë progresivisht nëpër nivelet e kurrikulës;
4. Mësuesit duhet t'i dinë qëllimet e mësimit dhe kriteret e suksesit të mësimit të tyre, të dinë sa po i përmbushin këto kritere për të gjithë nxënësit, dhe të dinë se ku të shkojnë më tej në hendekun mes njohurive dhe të kuptuarit aktual të nxënësve dhe kriterëve të suksesit, që janë: “Ku po shkon?”, “Si po shkon?”, dhe “Nga do shkosh pastaj?”;
5. Mësuesit duhet të kalojnë nga ideja e vetme në ide të shumfishta, dhe t'i lidhin dhe më pas t'i shtrijnë këto ide në mënyrë që nxënësit t'i ndërtojnë dhe rindërtojnë njohuritë dhe idetë e tyre. Me rëndësi kritike nuk është njohuria ose idetë, por konstrukti i nxënësit mbi këtë njohuri dhe ide;
6. Udhëheqësit e shkollave dhe mësuesit duhet të krijojnë mjedise shkollore, të stafit, dhe në klasë, ku gabimi është i mirëpritur si një mundësi për mësuesin, ku është e mirëpritur hedhja poshtë e njohurive dhe të të kuptuarit të pasaktë, dhe ku pjesëmarrësit mund të ndihen të sigurt për mësuesinë, ri-mësuesin, dhe eksplorim të njohurive dhe të kuptuarit.

Dokumenti i Komisionit Evropian (2013) për *Mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimit për rezultate më të mira të mësimit* e përshkruan profesionalizmin e mësimit të rinj duke dalluar mësuesit e pajisur me aftësinë për t'i integruar njohuritë, për ta trajtuar kompleksitetet, dhe për t'u përshtatur me nevojat e nxënësve individualë dhe grupeve të nxënësve. Në këtë kontekst, kompetencat e mësimit ngrihen mbi një koncept të mësimit si praksë në të cilën teoria, praktika dhe aftësia për të reflektuar në mënyrë kritike mbi praktikën vetanake dhe të të tjerëve, ndriçojnë njëra-tjetrën, dhe jo mbi një koncept të mësimit të bazuar në përvetësimin e shkathtësive teknike.

Për më tepër, Day (2017) ka vënë në dukje se mësuesit duhet t'u ndihmojnë nxënësve të fitojnë jo vetëm shkathtësitë që mësohen dhe testohen lehtë, por më e rëndësishmja:

- *mënyrat e të menduarit* (p.sh. kreativiteti, të menduarit kritik, zgjidhja e problemeve, vendimmarrja dhe mësuesia)

- *mënyrat e punës* (d.m.th. komunikimi dhe bashkëpunimi)
- *mjetet për të punuar* (d.m.th. teknologjitë e informacionit dhe komunikimit); dhe
- *shkathtësitë rreth qytetarisë, jetës dhe karrierës, dhe përgjegjësinë personale dhe sociale për suksesin në demokracitë moderne.*

Kompleksiteti i zgjeruar i profesionit të mësimdhënësit tregon nevojën për zhvillimin e të kuptuarit të përbashkët mbi përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit.

2.2.2 Korniza e kompetencave të përgatitjes së mësimdhënësve

Kompetencat e mësimdhënies janë kombinime komplekse të njohurive, shkathtësive, të kuptuarit, vlerave dhe qëndrimeve, që çojnë në veprime efektive në situata të ndryshme. Meqenëse mësimdhënia është shumë më shumë sesa një detyrë, dhe përfshin vlera ose supozime në lidhje me edukimin, mësimnxënien dhe shoqërinë, koncepti i kompetencave të mësimdhënësve mund të rezonojë ndryshe në kontekste të ndryshme kombëtare (Caena, 2011, 2014).

Analiza e gjendjes për programet e përgatitjes së mësimdhënësve në Kosovë (2020) konfirmon se njohuritë dhe shkathtësitë e lidhura me mësimnxënien dhe mësimdhënien janë më pak të zhvilluara, dhe roli i përgatitjes së mësimdhënësve është i konceptuar më ngushtë se sa që realisht është. Gjetjet nga analiza e situatës për programet tregojnë se zhvillimi i njohurive është prioritet në programet e përgatitjes së mësimdhënësve, sic theksohet nga vet profesorët. Ndërsa, shkathtësitë zhvillohen kryesisht gjatë periudhës së praktikës dhe zhvillimi i shkathtësive nuk është prioritet në programe. Në anën tjetër, zhvillimi i qëndrimeve, besimeve dhe vlerave për profesionin e mësimdhënësit, është komponenti më së paku i adresuar në programe. Disa institucione e kanë injoruar plotësisht komponentin e qëndrimeve, besimeve dhe vlerave, çka pasqyrohet edhe në nivelin parauniversitar.

Për t'i adresuar problemet e lartpërmendura, kjo politikë siguron një kornizë për përgatitjen e mësimdhënësve para shërbimit dhe zhvillimin e mësimdhënësve të ardhshëm që vazhdimisht sjellin risi dhe përshtaten, përfshirë mësimdhënësit që kanë qëndrime kritike dhe të bazuara në dëshmi, çka u mundëson të reagojnë ndaj rezultateve të nxënësve me dëshmi të reja nga brenda dhe jashtë klasës, dhe të zhvillojnë dialog profesional, në mënyrë që t'i përshtatin praktikatat e tyre.

Politika ka paraparë se kompetencat e mësimdhënësve duhet të jenë të vendosura në kontekstin më të gjerë të kornizës evropiane për të siguruar që të gjithë mësimdhënësit e ardhshëm në Kosovë të ketë kompetenca (njohuritë, shkathtësitë dhe qëndrimet) që kërkohen për mësimdhënie në shekullin e 21-të.

Përveç standardeve vendore për sigurimin e cilësisë dhe kornizës për zhvillim të mësimdhënësve, kjo politikë përvetëson edhe kornizën evropiane për mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve (*shih Tabelën 2*). Kompetencat e mësimdhënësve rrjedhin nga një shqyrtim i gjerë i këndvështrimeve nga literatura e hulumtimeve dhe politikave (p.sh., Darling-Hammond & Bransford, 2005; Feiman-Nemser, 2008; González & Eagenaar, 2005; Hagger & McIntyre, 2006; Krauss et al., 2008; Williamson Mc Diarmid & Cleverger-Bright, 2008).

Tabela 2: Korniza për planifikimin e përmirësimit dhe zhvillimit të kurrikulës (burimi: Korniza e BE-së [për mbështetjen e zhvillimit të kompetencave të mësimdhënësve](#))

Kategoritë	Fusha e kompetencës
<i>Njohuritë dhe të kuptuarit</i>	Njohuritë për përmbajtjen e lëndës
	Njohuritë për Përmbajtjen Pedagogjike (NJPP), që nënkupton njohuri të thella në lidhje me përmbajtjen dhe strukturën e lëndës: - njohuritë për detyrat, kontekstet dhe objektivat e mësimnxënies - njohuritë për dijet paraprake të nxënësve dhe vështirësitë e përsëritura të mësimnxënies për lëndë specifike - njohuritë strategjike për metodat mësimore dhe materialet kurrikulare
	Njohuritë pedagogjike (njohuri për proceset e mësimdhënies dhe të mësimnxënies)
	Njohuritë kurrikulare (njohuri të kurrikulës lëndore - p.sh. mësimnxënia e planifikuar dhe e drejtuar për përmbajtjen e lëndëve specifike)
	Bazat e shkencave të edukimit (njohuri ndërkulturore, historike, filozofike, psikologjike, sociologjike)
	Aspektet kontekstuale, institucionale, organizative të politikave arsimore
	Çështjet e përfshirjes dhe diversitetit
	Përdorimi efektiv i teknologjive në mësimnxënie
	Psikologjia zhvillimore
	Proceset dhe dinamikat në grup, teoritë e mësimnxënies, çështjet motivuese
	Proceset dhe metodat e vlerësimit
	<i>Shkathtësitë</i>
Përdorimi i materialeve dhe teknologjive të mësimdhënies	
Menaxhimi i nxënësve dhe grupeve	
Monitorimi, përshtatja dhe vlerësimi i objektivave dhe proceseve të mësimdhënies/mësimnxënies	
Mbledhja, analizimi, interpretimi i dëshmive dhe të dhënave (rezultatet e mësimnxënies të shkollës, rezultatet e vlerësimeve të jashtme) për vendime profesionale dhe përmirësimin e mësimdhënies/mësimnxënies; përdorimi, zhvillimi dhe krijimi i njohurive hulumtuese për t'i informuar praktikantët	
Bashkëpunimi me kolegët, prindërit dhe shërbimet sociale	
Shkathtësitë negociuese (ndërveprime sociale dhe politike me shumë palë të interesit, akterë dhe kontekste arsimore)	
Shkathtësitë reflektuese, metakognitive, ndërpersonale për mësimnxënie individuale dhe në komunitetet profesionale	
Përshtatja ndaj konteksteve arsimore të karakterizuara nga dinamika me shumë nivele me ndikime të kryqëzuara (nga niveli makro i politikave qeveritare te niveli meso i konteksteve shkollore dhe niveli mikro i klasës dhe dinamikës së studentëve)	
Përshtatja ndaj konteksteve arsimore të karakterizuara nga dinamika me shumë nivele me ndikime të kryqëzuara (nga niveli makro i politikave qeveritare te niveli meso i konteksteve shkollore dhe niveli mikro i klasës dhe dinamikës së studentëve)	
<i>Prirjet: besimet, qëndrimet, vlerat, përkushtimi</i>	Vetëdijesimi epistemologjik (çështjet që kanë të bëjnë me tiparet dhe zhvillimin historik të fushës dhe statusit të saj, në lidhje me fushat e tjera lëndore)
	Shkathtësitë për mësimdhënie përmes përmbajtjes
	Shkathtësitë e bartshme (transferueshme)
	Prirjet ndaj ndryshimit, fleksibiliteti, mësimnxënia dhe përmirësimi i vazhdueshëm profesional, përfshirë studimin dhe hulumtimin
	Përkushtimi ndaj promovimit të mësimnxënies së të gjithë nxënësve
	Prirjet ndaj promovimit të qëndrimeve dhe praktikave demokratike të studentëve, si qytetarë evropianë (përfshirë vlerësimin e diversitetit dhe multikulturalitetit)
	Qëndrimet kritike ndaj mësimdhënies vetanake (ekzaminimi, diskutimi, marrja në pyetje e praktikave)
	Prirjet ndaj punës ekipore, bashkëpunimit dhe rrjetëzimit
Ndjenja e vetë-efikasitetit	

3 Politika për sigurim të cilësisë për përgatitjen e mësimeve në Kosovë

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj pjese është të sigurojë një kornizë të politikës për sigurim të cilësisë për institucionet për përgatitje të mësimeve në Kosovë. Politika fokusohet në standardet dhe mekanizmat që do të zbatohen në nivel:

- i. *Institucional* - praktikat për sigurim të cilësisë në nivel institucional
- ii. *Programi* - praktikat për sigurim të cilësisë në nivelin programi
- iii. *Klase* - praktikat për sigurim të cilësisë në nivelin klase

Në pjesët vijuese, për secilën prej këtyre fushave ofrohen objektiva/rekomandime specifike për zbatimin e zhvillimit të kompetencave të mësimeve të ardhshëm.

3.1 Niveli institucional

Praktikat menaxheriale dhe administrative

1. Fakulteti i Edukimit duhet të ketë një deklaratë vizioni që mishëron analizat më të mira për mësime dhe mësues, dhe që njihet si një drejtim i përbashkët i zhvillimit. Vizioni i fakultetit të edukimit është edukimi cilësor dhe bashkëkohor dhe zhvillimi i mësimeve profesionale për shekullin e 21-të.
2. Fakulteti i Edukimit duhet të ketë një deklaratë të përcaktuar të misionit që përfshin mësime, hulumtimin shkencor, zhvillimin dhe shërbimin ndaj komunitetit. Misioni shqyrtohet në mënyrë periodike për t'iu përshtatur ndryshimit të rrethanave
3. Objektivat afatmesme dhe afatgjata të Fakultetit të Edukimit janë në përputhje me misionin e FEdu-së dhe e mbështesin atë.
4. Objektivat afatmesme dhe afatgjata përfshijnë edhe objektiva për trajnimin e mësimeve gjatë shërbimit.
5. FEdu-ja ka një plan strategjik për një periudhë prej së paku tre vjetësh, dhe ky shqyrtohet periodikisht për t'iu përshtatur ndryshimit të rrethanave
6. Ekzistojnë politika, udhëzime dhe rregullore formale që kanë të bëjnë me çështje të përsëritura procedurale ose akademike dhe menaxheriale. Këto bëhen publike për të gjithë stafin dhe studentët.
7. Të gjitha politikat, rregulloret, termat e referencës dhe deklaratat e përgjegjësisë në lidhje me menaxhimin dhe ofrimin e programit, shqyrtohen të paktën një herë në dy vjet, dhe ndryshohen siç kërkohet për t'iu përshtatur ndryshimit të rrethanave.
8. Fakulteti i Edukimit themelon një organ këshillimor, me përfaqësues nga tregu i punës, vendimmarrës në institucione publike dhe private, dhe përfaqësues të OJQ-ve. Fakulteti dhe organi këshillimor bashkëpunojnë për studime dhe hulumtime, shërbime profesionale, zbatimin e projekteve, dhe partneritete të tjera.
9. Fakulteti i Edukimit i siguron MASH-it këshilla të bazuara në dëshmi për politikat, dhe drejton debatet kombëtare për reformimin e përgatitjes së mësimeve.

10. Fakulteti i Edukimit zhvillon një program të fazës hyrëse për mësimdhënësit fillestarë për të mbështetur socializimin e të diplomuarve në shkollë, për të shmangur shterimin profesional, dhe për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional.

Hulumtimi

1. Fakulteti i Edukimit përcakton objektiva shkencore/të hulumtimeve të aplikuara dhe zhvillon strategji për hulumtimet, e cila shqyrtohet në mënyrë periodike për t'iu përshtatur ndryshimit të rrethanave
2. Janë vendosur politika të qarta për përcaktimin e asaj që njihet si hulumtim, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe normat e vendosura në fushën e studimit të programit.
3. Stafit akademik inkurajohen të përfshijnë në informacionin e tyre të mësimdhënies aktivitetet e tyre hulumtuese dhe shkencore që janë relevante për kurset që ata japin, së bashku me zhvillime të tjera të rëndësishme të hulumtimeve në këtë fushë.
4. Studentët janë të angazhuar në projekte hulumtimi dhe aktivitete të tjera.
5. Hulumtimet ndërlidhen me zhvillimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe zhvillimin e shkollës. Shërbejnë për qëllime të mësimdhënies në shkolla, si dhe për mësimdhënie në programet e përgatitjes së mësimdhënësve. Duhet të jenë të natyrës bazike dhe të aplikuar dhe duhet të sigurojnë inputet e mjaftueshme për politikëbërje arsimore dhe praktika të zhvillimit.

Ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi

1. Fakulteti i Edukimit harton dhe miraton një strategji/politikë për bashkëpunimin institucional dhe/ose ndërkombëtarizim, e cila i drejton vendimet dhe shpërndarjen e burimeve në këtë fushë.
2. Fakulteti i Edukimit krijon dhe ia cakton portofolin e bashkëpunimit institucional dhe/ose ndërkombëtarizimit, një anëtar të menaxhmentit të lartë që është drejtpërdrejt i mandatuar dhe i përgjegjshëm për iniciativat dhe rezultatet në këtë fushë.
3. Fakulteti i Edukimit ka marrëveshje dhe memorandume të ndryshme mirëkuptimi me partnerë dhe organizata relevante ndërkombëtare. Përgjegjësitë e partnerëve përcaktohen qartë në marrëveshjet zyrtare.
4. Fakulteti i Edukimit merr pjesë, si udhëheqës ose si partner, në projekte ndërkombëtare.
5. Fakulteti i Edukimit organizon evente me vizibilitet dhe shtrirje ndërkombëtare (konferenca, shkolla verore, etj.)
6. Fakulteti i Edukimit inkurajon vizibilitetin ndërkombëtar të stafit dhe studentëve të vet, duke mbështetur pjesëmarrjen e tyre në mobilitet të ndryshme studimore, forume, evente, praktika, shkolla verore, seminare, etj.

Zhvillimi i stafit

1. Fakulteti i Edukimit kryen shqyrtimin e rregullt të punës mësimdhënëse dhe hulumtuese të stafit

2. Fakulteti i Edukimit zhvillon një sistem vjetor të vlerësimit të performancës për stafin e vet akademik dhe administrativ.
3. Stafi akademik merr pjesë rregullisht në skemat e mobilitetit
4. Fakulteti i Edukimit organizon seminare dhe uebinare për zhvillim të vazhdueshëm profesional të stafit të vet akademik

Shërbimet për studentët

5. Studentët marrin pjesë rregullisht në skemat e mobilitetit
6. Mbahet kontakt i rregullt me alumni, duke i mbajtur të informuar për zhvillimet institucionale, duke i ftuar të marrin pjesë në aktivitete, dhe duke inkurajuar mbështetjen e tyre për zhvillimet e reja.

3.2 Niveli i Programit

- 1 Programet e studimit janë në përputhje me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve dhe Kornizën për Kualifikimet e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë.
- 2 Orientimi konceptual i programeve të studimit promovon një qasje të mirë-përcaktuar didaktike dhe hulumtuese, dhe të bazuar në hulumtime
- 3 Programet pasqyrojnë edhe çështje rreth reformës së kurrikulës kombëtare; adresojnë çështjet e zhvillimit shoqëror dhe kulturor, përveç përmbajtjes dhe shkathtësive që duam që gjeneratat e reja t'i mësojnë dhe t'i zhvillojnë
- 4 Programet e studimit modelohen sipas objektivave të kualifikimit. Këto përfshijnë aspekte të ndërlidhura dhe ndër-disiplinore, si dhe përvetësimin e shkathtësive dhe kompetencave disiplinore, metodologjike dhe të përgjithshme
- 5 Programet e studimit pasqyrojnë çështjen e praktikës pedagogjike. Programet i ekspozojnë studentët sa më shumë që të jetë e mundur ndaj realiteteve të shkollës, dhe jo vetëm ndaj detyrave të mësimdhënies, por edhe ndaj përvojave të të qenurit anëtar i shkollës, kulturës shkollore, praktikave të menaxhimit, punës me prindërit, bashkëpunimit kolegjial, zhvillimit të kurrikulës dhe mësimin, testimit të studentëve, etj.
- 6 Për t'i lehtësuar fazat e praktikës, Fakulteti i Edukimit nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi, kontrata ose dokumente të tjera me institucione/organizata/njësi të punës praktike. Janë vendosur marrëdhënie me institucionet dhe punëdhënësit lokalë për të ndihmuar në realizimin e programit (këto mund të përfshijnë vendosjen e studentëve për programe studimi në punë, mundësi punësimi me kohë të pjesshme, dhe identifikimin e çështjeve për analizë në aktivitetet e projekteve studentore).
- 7 Hartohen udhëzime për praktikën e studentëve, duke përshkruar të gjitha përgjegjësitë e palëve dhe kriteret e vlerësimit të studentëve. Detyrat e caktuara për studentët gjatë praktikës i tejkalojnë detyrat formale, d.m.th. studentët mësimdhënës mund të kryejnë hulumtime veprimi dhe ta përdorin këtë si kontribut për punimin e diplomës bachelor/master
- 8 Kurset në kuadër të programit kanë syllabuse analitike që përmbajnë objektivat e lëndës, përmbajtjen, rezultatet e mësimnxënies, ngarkesën e studentit, shpërndarjen e orëve, seminareve dhe aktiviteteve aplikuese, sistemin e vlerësimit, bibliografinë, etj.
- 9 Programet shqyrtohen rregullisht (së paku çdo dy vite) nga departamentet, duke analizuar dy aspekte: 1) përmbajtjen e programit dhe 2) realizimin e programit

- 10 Strategjitë e mësimdhënies janë të përshtatshme për llojet e ndryshme të rezultateve të mësimnxënies që programet synojnë të zhvillojnë.
- 11 Mekanizmat e vlerësimit të studentëve përdoren në mënyrë të drejtë dhe objektive, janë të përshtatshme për format e ndryshme të mësimnxënies të kërkuar, dhe u komunikohen qartë studentëve në fillim të kurseve. Përdoren si teknikat e vlerësimit formativ ashtu edhe atij përmbledhës
- 12 Për verifikimin e kompetencave të arritjeve të studentëve përdoren mekanizma të përshtatshëm, valid dhe të besueshëm.
- 13 Zbatohet një qasje programore për përgatitjen e mësimdhënësve për të parandaluar fragmentimin dhe copëzimin e njohurive dhe shkathtësive, dhe për të nxitur një qasje ndërdisiplinore
- 14 Zhvillimi i njohurive, shkathtësive dhe prirjeve (vlerat, qëndrimet, besimet) sintetizohen në të gjitha rezultatet e mësimnxënies së kursit dhe metodave të vlerësimit. Metodave të vlerësimit inkurajojnë zhvillimin e shkathtësive për kryerjen me sukses të profesionit të ardhshëm, dhe i kushtohet vëmendje zhvillimit të vlerave dhe qëndrimeve pozitive për profesionin e mësimdhënësit.
- 15 Programet fokusohen në zhvillimin e mësimdhënësve që janë:
 - 15.1 mësimdhënës strategjikë që janë të aftë të japin mësim në fusha të ndryshme
 - 15.2 mësimdhënës që i kuptojnë dhe reagojnë ndaj situatave të ndryshme
 - 15.3 mësimdhënës që janë të gatshëm të përballojnë situata të ndryshme përmes teknikave të ndryshme
 - 15.4 mësimdhënës që mund të japin mësim edhe nëse nuk janë në mjedise fizike të klasës
 - 15.5 mësimdhënës që i lidhin situatat me probleme të jetës reale
 - 15.6 mësimdhënës që i motivojnë nxënësit të mësojnë.
- 16 Hulumtimi në veprim, si metodë për përmirësim të mësimdhënies vetanake, është i integruar në procesin e mësimnxënies.
- 17 Është siguruar lidhje e fortë mes teorisë dhe praktikës
- 18 Është prioritarizuar zhvillimi i kompetencave transversale. Në mënyrë që studentët mësimdhënës të përgatiten për t'i zhvilluar kompetencat e bartshme të nxënësve të tyre (kompetencat e shekullit të 21-të), procesi i mësimnxënies në universitet duhet të mbështesë zhvillimin e kompetencave të bartshme të mësimdhënësve të ardhshëm. Procesi i mësimnxënies duhet të përfshijë më shumë punë në projekte, punë ekipore, planifikimin e aktiviteteve vetanake të mësimnxënies, dhe zhvillimin e shkathtësive të udhëheqësisë. (LifeComp: Korniza Evropiane për Kompetencat Kyçe Personale, Sociale dhe të Mësimnxënies për Mësimnxënie)
- 19 Fokusi vihet në zhvillimin e qëndrimeve dhe praktikave demokratike të mësimdhënësve të ardhshëm, përfshirë vlerësimin e diversitetit dhe multikulturalitetit, si qytetarë të ardhshëm evropianë.
- 20 Përdoret teknologjia arsimore në mësimdhënie.
- 21 Gjatë gjithë programit mbështetet metakognicioni dhe vetë-reflektimi në lidhje me mësimdhënien vetanake të mësimdhënësve (shqyrtimi, diskutimi, pyetjet)
- 22 Kryhet rregullisht vlerësimi vjetor i lëndës dhe programit dhe procesi përfshin menaxhmentin, stafin dhe studentët.

3.3 Niveli i klasës

1. Qasja në klasë promovon mësimdhënie dhe mësimnxënie me studentin në qendër
2. Edukimi holistik - Programet ndërtohen për të përgatitur studentë mësimdhënës për mësimnxënie të diferencuar dhe diversitet në klasë. Mësimdhënësit trajnohen jo vetëm që të përcjellin përmbajtjen, por edhe të marrin rolin e udhëheqësit të komunitetit
3. Integrimi i teorisë dhe praktikës: Është e rëndësishme jo vetëm të ekuilibrohen kurset mbi pedagogjinë, përmbajtjen dhe praktikën, por edhe të lehtësohet integrimi i teorisë dhe hulumtimit akademik me praktikën.
4. Reflektimi është një komponent thelbësor si në zhvillimin profesional ashtu edhe në atë personal, pasi krijon vetëdijesim që individi të kujtojë dhe përsosë praktikën e vet. Reflektimi përdoret në procesin e detyrave të kursit dhe vihet në praktikë pas çdo ore mësimore për t'i inkurajuar studentët mësimdhënës të reflektojnë me vetëdije dhe në mënyrë metodike mbi supozimet e tyre.
5. Njerëzit vijnë në studime me besime, vlera, përkushtime, personalitete dhe kode morale të krijuara nga rritja dhe shkollimi i tyre, dhe këto ndikojnë në atë se kush janë ata si mësimdhënës dhe çfarë janë në gjendje të mësojnë gjatë përgatitjes profesionale dhe gjatë mësimdhënies. Një detyrë qendrore e përgatitjes së mësimdhënësve është të ndihmohen studentët mësimdhënës që t'i shqyrtojnë në mënyrë kritike bindjet dhe vlerat e tyre për mënyrën si lidhen ato me mësimdhënien, mësimnxënien dhe lëndën, dhe të formojnë një vizion për mësimdhënien e mirë që e drejton dhe frymëzon mësimnxënien dhe punën e tyre (Fieman-Nemser, 2001)

4. Strategjia e zbatimit

Qëllimi i kësaj pjese është të sigurojë udhëzime të hollësishme për t'u ndihmuar institucioneve për përgatitje të mësimdhënësve për planifikimin strategjik dhe zbatimin e dispozitave të politikës së sigurimit të cilësisë. Këtu ofrohet një plan për zbatimin e mekanizmave të brendshëm të sigurimit të cilësisë për të siguruar që ato të kontribuojnë drejt përgatitjes së mësimdhënësve të orientuar drejt cilësisë.

Udhëzimet për zbatimin e politikës së sigurimit të cilësisë janë strukturuar dhe planifikuar si më poshtë (shih Tabelën 3):

- i. Instrumentet (instrumentet ekzistuese institucionale për sigurim të cilësisë) dhe Qëllimi (qëllimi i secilit instrument individual)
- ii. Grupi(et) e synuar (kush është targetuar për të dhënë reagime)
- iii. Akterët institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre (kush është përgjegjës për ta dizajnuar, shpërndarë, monitoruar procesin)
- iv. Afati kohor (sa shpesh dhe kur do të shpërndahen instrumentet)
- v. Procesi (si do të shpërndahen instrumentet, si do të analizohen dhe pasqyrohen të dhënat, përdorimi i të dhënave për mentorim dhe ndërhyrje të mundshme)

Tabela 3: Plani i zbatimit të mekanizmit të sigurimit të cilësisë

Struktura	Instrumenti dhe qëllimi	Grupi(et) i targetuar	Akterët institucionalë dhe përgjegjësitë e tyre	Afati kohor	Procesi
Vlerësimi i lëndës dhe programit	<i>Opinionet e studentëve</i> për (i) monitorimin e mësimdhënies dhe mësimnxënies dhe (ii) mbështetjen e mësimnxënies të studentëve	Studentët	Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi Koordinatori i ZZHA	Dy herë gjatë vitit akademik (në fund të çdo kursi) semestri)	<ul style="list-style-type: none"> – Studentët marrin pyetësonin online pas përfundimit të kursit – Pjesëmarrja e studentëve është vullnetare – Koordinatori i ZZHA (nën udhëheqjen e Prodekanit) analizon të dhënat dhe siguron raporte të shkurtra në fund të çdo viti akademik për shefat e departamenteve dhe të gjithë stafin – Raportet përdoren për reflektimin e stafit për rishikimet e kurseve – Raportet pasqyrohen edhe në shqyrtimin e ardhshëm të programit dhe raportin e përgjithshëm të vetë-vlerësimit për akreditimin.
	<i>Opinionet e studentëve</i> për përvojat e trajnimit praktik në shkollë	Studentët	Prodekanët për mësim (BA dhe MA) Zyrtari për praktikën shkollore	Pas përfundimit të secilës periudhë të praktikës shkollore	<ul style="list-style-type: none"> – Studentët do të marrin një pyetëson pasi ta kenë përfunduar praktikën/vendosjen e tyre në shkollë – Pjesëmarrja e studentëve është vullnetare – Prodekanët për mësim (BA dhe MA) në bashkëpunim me zyrtarin për praktikë/vendosje në shkollë, do të analizojnë të dhënat dhe do të japin raporte të shkurtra në fund të çdo viti akademik – Raportet do të përdoren për t'i kuptuar më mirë sfidat dhe përvojat e studentëve gjatë praktikës në shkollë, në përpjekje për ta përmirësuar procesin dhe rezultatin – Raportet do të pasqyrohen edhe në planet për ta përmirësuar praktikën/vendosjen në shkollë dhe mësimnxënien e studentëve.

	<p>Shqyrtimi i programit dhe syllabuseve për arritjen e objektivave të programit dhe kurseve</p>	<p><i>Shqyrtimi i programit</i></p> <p>Studentët dhe stafi akademik, drejtuesit e departamenteve</p>	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p> <p>Koordinatori i ZZHA)</p>	<p>Periodikisht (çdo 2 vjet)</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Stafi akademik: merret një anketë dhe merret pjesë në grupe fokusi (lehtësuar nga shefat e departamenteve) çdo 2 vjet, për të analizuar arritjen e objektivave të programit dhe për të identifikuar fushat për përmirësim; – Studentët: (lehtësuar nga shefat e departamenteve) do të marrin pjesë në grupe fokusi çdo 2 vjet – Qëllimi i organizimit të grupeve të fokusit është t'u lejohet studentëve dhe stafit akademik të japin reagime dhe të reflektojnë mbi arritjen e objektivave të programit – Ky aktivitet periodik synon të sigurojë rishikimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit – Prodekani për studime të doktoraturës , zhvillim dhe cilësi do të hartojë një plan ndërhyrjeje për nevoja specifike të programit që rrjedhin nga shqyrtimi – Prodekani për studime të doktoraturës , zhvillim dhe cilësi do të përpilojë një raport për mësimet e nxjerra, i cili do të pasqyrohet në akreditimin e programeve.
<p><i>Shqyrtimi i syllabuseve</i></p> <p>Grup i stafit akademik që japin kurse të ngjashme/të njëjta</p>		<p>Prodekanët për mësim (BA dhe MA)</p>	<p>Çdo fillim i semestrit (në varësi të lëndës)</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Para fillimit të semestrit, stafi akademik që japin kurse të ngjashme/të njëjta, do të marrin pjesë në diskutimet në grupe fokusi – Qëllimi i organizimit të grupeve të fokusit me stafin akademik që japin kurseve të ngjashme/të njëjta, është sigurimi i koherencës dhe koordinimit ndërmjet syllabuseve të ndryshme (p.sh. përshkrimi i kursit, rezultatet e mësimnxënies, metodat e mësimdhënies, vlerësimi, literatura, ndër të tjera) – Diskutimet në grupe fokusi do të lehtësohen nga Prodekanët për mësim (BA dhe MA) – Procesverbalet e diskutimit në grupe fokusi do të regjistrohen dhe do të ruhen si dëshmi për procesin e shqyrtimit të syllabuseve të kurseve 	

<p>Opinionet e punëdhënësve/ tregut të punës</p>	<p>Opinionet e institucioneve arsimore (kopshte, shkolla, etj.) për përmirësimin e praktikës profesionale/vendosjes në shkollë</p>	<p>Drejtorët e institucioneve</p>	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p>	<p>Një herë në vit në fund të çdo viti akademik</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Drejtorët e shkollave dhe mësime dhënësit (mentorët e studentëve mësime dhënësit) marrin një pyetësor online në fund të çdo viti akademik – Zyra e ZZHA është përgjegjëse për analizimin e të dhënave dhe sigurimin e një raporti të shkurtër në fund të çdo viti akademik – Të dhënat do të ndahen me shefat e departamenteve – Të dhënat do të përdoren gjatë shqyrtimit të programit dhe procesit të mësime dhënies.
<p>Opinionet dhe përvajtjet e alumni (të diplomuarve)</p>	<p>Opinionet e alumni se sa të përgatitur ndiheshin kur filluan punën</p>	<p>Alumni</p>	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p> <p>Koordinatori i ZZHA</p>	<p>Një herë në vit në fund të çdo viti akademik</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Alumni marrin një pyetësor online në fund të çdo viti akademik – Zyra e ZZHA është përgjegjëse për analizimin e të dhënave dhe sigurimin e një raporti të shkurtër në fund të çdo viti akademik – Të dhënat do të ndahen me shefat e departamenteve – Të dhënat do të përdoren gjatë shqyrtimit të programit dhe procesit të mësime dhënies.
<p>Zhvillimi institucional</p>	<p>Shqyrtimi i performancës së stafit (intervista të përshtatura për stafin akademik, plane zhvillimi të individualizuara për të mbështetur zhvillimin e tyre profesional dhe procesin e përparimit akademik)</p>	<p>Stafi akademik</p>	<p>Prodekanët për mësime (BA dhe MA) dhe shefat e departamenteve</p> <p><i>*Ky proces lehtësohet dhe mbikëqyrjet nga Dekani dhe Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</i></p>	<p>Në varësi të planit individual zhvillimor të stafit akademik</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Shefat e departamenteve do të plotësojnë një formular vlerësimi të performancës për secilin anëtar të departamentit, dhe do t’ua dërgojnë prodekanëve për mësime (BA dhe MA) – Prodekanët për mësime (BA dhe MA), së bashku me stafin akademik, do të përgatisin plane të individualizuara të zhvillimit profesional për secilin anëtar stafi akademik, bazuar në formularin e vlerësimit – Prodekanët për mësime (BA dhe MA), së bashku me drejtuesit e departamenteve, do të zhvillojnë intervista të përshtatura me secilin anëtar stafi akademik të paktën një herë në vit, për të shqyrtuar planet dhe identifikuar aktivitetet prioritare dhe planet e zhvillimit, si dhe për të ndjekur përmirësimin – Prodekanët për mësime (BA dhe MA) nën mbikëqyrjen e Dekanit do të japin reagime me shkrim për të gjithë stafin akademik pas intervistës (përmbledhje e vlerësimit të performancës +

					<p><i>intervista)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> – Gjatë intervistës dhe në kuadër të sistemit të vlerësimit të performancës, opinionet e studentëve për kurset do të përfshihen në procesin e diskutimit të prioriteteve për përmirësim dhe planeve individuale të zhvillimit.
	<p>Opinionet e studentëve për proceset dhe shërbimet administrative dhe praktikat e zhvillimit institucional (cilësia e menaxhimit; kultura organizative etj.)</p>	Studentët	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p> <p>Koordinatori i ZZHA</p>	Një herë në vit në fund të çdo viti akademik	<ul style="list-style-type: none"> – Studentët mësimdhënës marrin pyetësorin online pas përfundimit të vitit akademik – Pjesëmarrja e studentëve është vullnetare – Zyra e ZZHA është përgjegjëse për analizimin e të dhënave dhe sigurimin e një raporti të shkurtër në fund të çdo viti akademik – Raportet do të përdoren për t'i kuptuar më mirë dhe për t'i përmirësuar proceset administrative dhe shërbimet dhe kulturën e menaxhimit – Sekretari i fakultetit do të marrë opinionet me shkrim për të gjithë stafin administrativ – Sekretari dhe Prodekani (për studime të doktoraturës, zhvillim dhe cilësi), së bashku me stafin administrativ, do të përgatisin plane individuale të zhvillimit profesional për secilin staf administrativ, bazuar në formularin e vlerësimit – Prodekani (për studime të doktoraturës , zhvillim dhe cilësi), së bashku me Dekanin, hartojnë strategjinë dhe planet për përmirësim institucional.
	<p>Opinionet/reflektimet e stafit administrativ për proceset dhe shërbimet administrative dhe praktikat e zhvillimit institucional (cilësia e menaxhimit; kultura organizative etj.)</p>	Stafi administrativ	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p> <p>Koordinatori i ZZHA</p>	Në fund të çdo viti akademik	<ul style="list-style-type: none"> – Stafi administrativ marrin një pyetësor online në fund të çdo viti akademik – Pjesëmarrja është vullnetare – Zyra e ZZHA është përgjegjëse për analizimin e të dhënave dhe sigurimin e një raporti të shkurtër në fund të çdo viti akademik – Raportet do të përdoren për t'i kuptuar më mirë dhe për t'i përmirësuar proceset administrative – Sekretari i fakultetit, nën mbikëqyrjen e Dekanit, do të ofrojë raport me shkrim për të gjithë stafin administrativ – Sekretari dhe Prodekani (për studime të doktoraturës, zhvillim dhe cilësi), së bashku me

					<p>stafin administrativ, do të përgatisin plane individuale të zhvillimit profesional për secilin staf administrativ, bazuar në formularin e vlerësimit</p> <ul style="list-style-type: none"> – Prodekani (për studime të doktoraturës, zhvillim dhe cilësi), së bashku me Dekanin, hartojnë strategjinë dhe planet për përmirësim institucional.
	<p>Shqyrtimi i vëllimit, cilësisë dhe profilit të hulumtimeve të stafit dhe hulumtimeve institucionale</p>	<p>Shqyrtimi i CV-ve të stafit akademik</p>	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësië</p> <p>Koordinatori i ZZHA)</p> <p>Ekipi përgjegjës në IHZHA</p>	<p>Një herë në vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Zyra e ZZHA është përgjegjëse që të përgatisë një shabllon dhe ta ndajë me stafin akademik për të ndjekur vëllimin e botimeve të hulumtimeve të tyre – Stafit akademik u kërkohet të japin të dhëna për kontributin e tyre shkencor, duke e plotësuar dhe dërguar shabllonin një herë në vit – Ekipi në IHZHA është përgjegjës për ta analizuar vëllimin, cilësinë dhe profilin e hulumtimeve institucionale dhe të stafit një herë në vit – Ekipi në IHZHA do të përpilojë një raport nga analiza e kryer – Ekipi në IHZHA do të sigurojë mbështetje dhe shërbime këshillimi në lidhje me hulumtimin dhe publikimin për të gjithë stafin e interesuar akademik – Dekani (<i>si pjesë e vlerësimit dhe zhvillimit të performancës</i>) do të diskutojë individualisht me secilin anëtar stafi akademik për të siguruar angazhim të zgjeruar shkencor për vitin e ardhshëm akademik.
	<p>Shqyrtimi i bashkëpunimit ndërkombëtar</p>	<p>Shqyrtimi i bashkëpunimit të projekteve individuale dhe institucionale</p>	<p>Prodekani për studime të doktoratës, zhvillim dhe cilësi</p> <p>Koordinatori i ZZHA</p>	<p>Një herë në vit</p>	<ul style="list-style-type: none"> – Zyra e ZZHA-së është përgjegjëse që të përgatisë një shabllon dhe ta ndajë me stafin akademik për të ndjekur bashkëpunimin e tyre ndërkombëtar (<i>individual dhe institucional</i>) – Zyra e ZZHA-së do të përgatisë shabllone dhe procese për të ndjekur studentët dhe stafin që vjen dhe shkon (mobiliteti përmes ERASMUS dhe programeve të tjera) – Në fund të çdo viti, zyra e ZZHA do të sigurojë një raport për bashkëpunimin ndërkombëtar – Dekani (<i>si pjesë e vlerësimit dhe zhvillimit të</i>

					<i>performancës</i>) do të diskutojë individualisht me secilin anëtar stafi akademik për të siguruar bashkëpunim të zgjeruar ndërkombëtar për vitin pasues akademik.
--	--	--	--	--	-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------

Ekzistojnë një numër dokumentesh (siç është specifikuar në Tabelën 3) si pjesë e praktikave për sigurim të cilësisë, që do t'u ndihmojnë institucioneve për përgatitje të mësimdhënësve në ndërmarrjen e ndërhyrjeve të nevojshme për përmirësimin dhe ndryshimin e cilësisë, siç janë:

- Raportet vjetore
- Raportet e vetëvlerësimit (për akreditim)
- Planet për përmirësimi dhe ndryshim (përfshirë planet strategjike)

Individët dhe ekipet përgjegjëse do të përpilojnë plane përmirësimi dhe ndryshimi bazuar në dëshmitë e mbledhura gjatë gjithë vitit. Planet e përmirësimit dhe ndryshimit do të monitorohen dhe vlerësohen me kujdes për të siguruar arritjen e rezultateve të pritura.

5. Referencat

- Caena, F. (2011) *Shqyrtim i literaturës. Kompetencat themelore të mësimit dhe zhvillimit. Komisioni Evropian.*
https://ec.europa.eu/assets/eac/education/experts-groups/2011-2013/teacher/teacher-competences_en.pdf
- Caena, F. (2014). Kornizat e kompetencave të mësimit në Evropë: Politika si diskurs dhe politika si praktikë. *European Journal of Education*, 49(3), 311-331.
<https://doi.org/10.1111/ejed.12088>
- Darling-Hammond, L. & Bransford, J. (2005). *Përgatitja e mësimit për një botë në ndryshim. Raporti i komitetit për edukimin e mësimit të Akademisë Kombëtare të Edukimit.* Jossey-Bass.
- Day, C. (2017). *Botët dhe puna e mësimit: të kuptuarit e kompleksitetit, ndërtimi i cilësisë.* Routledge.
- Day, C., & Gu, Q. (2010). *Jetët e reja të mësimit.* Routledge.
- Komisioni Evropian (2013). *Mbështetja e zhvillimit të kompetencave të mësimit për rezultate më të mira të mësimit.* Komisioni Evropian.
https://ec.europa.eu/assets/eac/education/policy/school/doc/teachercomp_en.pdf
- Feiman-Nemser, S. (2008). Mësimit e mësimit. Si mësojnë mësimit të japin mësimit? Në Cochran-Smith, M., Feiman-Nemser, S., McIntyre, D. (Eds.). *Doracak i Hulumtimit mbi Edukimin e Mësimit.* Pyetje që mbeten në kontekste në ndryshim. Neë York/Abingdon: Routledge/ Taylor & Francis.
- Fullan, M. (2007). *Kuptimi i ri i ndryshimit arsimor.* Teachers College, Columbia University.
- Gonzalez, J. & Wagenaar, R. (Eds.) (2005). *Akordimi i strukturave arsimore në Evropë II. Kontributi i universiteteve në Procesin e Bolonjës.* Universiteti i Deusto dhe Universiteti i Groningen. <http://tuning.unideusto.org/tuningeu/>
- Hagger, H. & McIntyre, D. (2006). *Të mësuarit e mësimit nga mësimit. Realizimi i potencialit të edukimit të bazuar në shkollë të mësimit.* Open University Press.
- Hargreaves, A. (2003). *Mësimit në shoqërinë e dijes. Edukimi në epokën e pasigurisë.* Open University Press.
- Hattie, J. (2009). *Mësimit e dukshme: Një sintezë e meta-analizave në lidhje me arritjet.* Routledge.

- Kaçaniku, F. (2018). *Ndikimi i procesit të akreditimit në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë në Kosovë*. Projekti për Rrjetin e Arsimit dhe Punësimit në Kosovë - KEEN. https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1440/the_impact_of_accreditation_process_on_quality_assurance.pdf
- Krauss, S., Brunner, M., Kunter, M., Baumert, J., Blum, E., Neubrand, M. & Jordan, A. (2008). Njohuritë për përmbajtjen pedagogjike dhe njohuritë për përmbajtjen të mësimdhënësve të matematikës në ciklin e mesëm. *Journal of Educational Psychology*, 100(3), 716-725.
- Mehmeti, S., Rraci, E., & Bajrami, K. (2019). *Zhvillimi profesional i mësimdhënësve në Kosovë*. Projekti KEEN. https://www.keen-ks.net/site/assets/files/1467/zhvillimi_profesional_i_mesimdhenesve_ne_kosove_eng.pdf
- Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. (2017). *Korniza Strategjike për Zhvillimin e Mësimdhënësve në Kosovë*. MASHT.
- QATEK. (2020). *Analiza e situatës për programet për edukim fillestar të mësimdhënësve*. QATEK
- QATEK. (2020). *Analiza e situatës për praktikën për sigurim të cilësisë në edukimin fillestar të mësimdhënësve*. QATEK.
- Williamson McDiarmid, G. & Clevenger-Bright, M. (2008). Të rimenduarit e kapacitetit të mësimdhënësve. Në Cochran-Smith, M., Feiman-Nemser, S. & McIntyre, D. (Eds). *Doracak i Hulumtimit mbi Edukimin e Mësimdhënësve*. Pyetje që mbeten në kontekste në ndryshim. Routledge/Taylor & Francis.